

VENDIM
Nr.215, datë 18.4.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.704, DATË 11.10.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET, SI DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.704, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në kapitullin III “Procedura e shitjes së pronës shtetërore”, të bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “c” e paragrafit të dytë të pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, fillimisht, duhet të vendosë njoftim, me afishe, në mjediset, ku do të organizohet zhvillimi i ankandit të tyre, ndërsa dega e shoqërive publike, në prefekturë, vendos afishe në mjediset e veta dhe në ndërmarrjen, ku ndodhet objekti që privatizohet, sipas të dhënave (afisheet dërguar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike).

DSHP-ja dërgon zyrtarisht procesverbal për vendosjen e afisheve, brenda afatit të botimit në Drejtorinë e Administrimit dhe të Shitjes së Pronave Publike.

b) Në pikën 9, fjalët “... përveç sa kërkohet në pikën 7...” zëvendësohen me “...përveç sa kërkohet në pikën 8...”.

c) Në pikën 12, fjalët “...botimi bëhet sipas pikës 5...” zëvendësohen me “...botimi bëhet sipas pikës 6...”.

ç) Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Të ardhurat nga vlera e shitjes së objektit ndahen:

- 5 për qind e vlerës së shitjes, Ministrisë së Financave;

- 5 për qind e vlerës së shitjes, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

- 5 për qind e vlerës së shitjes, ministrisë së varësisë administrative të objektit. Për rastet kur institucioni i varësisë administrative të objektit nuk ekziston, sipas pikës 4 kapitulli IV të vendimit nr.704, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave, të ardhurat i kalojnë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

- 85 për qind e vlerës së shitjes, Buxhetit të Shtetit.”.

d) Pas pikës 20 shtohet pika 20/1, me këtë përmbajtje:

“20/1.a) Kontratat e nënshkruara nga përfaqësuesi i ish-Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe i degëve të saj në rrethe, për objektet apo ndërmarrjet e privatizuara në vite, me përfaqësuesin e ndërmarrjes dhe blerësit, por jo sipas mënyrës së kërkuar nga ligji (para noterit), për rastet kur aktualisht nuk ekziston ndërmarrja, do të bëhen para noterit nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe blerësi, kur dokumentacioni, që ndodhet në arkivat e kësaj drejtorie, është i rregullt.

b) Për rastet kur nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe janë kryer të gjitha procedurat ligjore për privatizimin e objekteve apo të ndërmarrjeve shtetërore, sipas dokumentacionit të plotë, që ndodhet në arkivin e ish-AKP-së, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike (dosja e vlerësimit, ankandi apo e drejta e parablerjes, autorizimi për kalim pronësie, pagesa e plotë, dorëzimi etj.), por që, për arsye të ndryshme, nuk ka qenë e mundur të lidhet kontrata e shitjes dhe kur aktualisht nuk ekziston ndërmarrja, që e ka pasur në administrim objektin, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kryetari i degës së shoqërive publike, në prefekturë, në juridiksionin e të cilit ndodhet objekti, dhe blerësi nënshkruajnë kontratën e shitjes, sipas legjislacionit në fuqi.”.

2. Në kapitullin IV “Detyrat dhe të drejtat për zbatimin e këtij vendimi”, të bëhen këto

ndryshime:

a) Në pikën 4, fjalia “Respektimi i këtij afati kontrollohet nga organi përkatës i varësisë administrative” zëvendësohet “Respektimi i këtij afati kontrollohet nga dega e shoqërive publike përkatëse.”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Dokumentacioni i përgatitur nga komisioni i vlerësimit dërgohet për kontroll në degën e shoqërive publike përkatëse. Kur, pas kontrollit të degës së shoqërive publike, ky dokumentacion rezulton i rregullt, në përputhje me legjislacionin e privatizimit, ai i dërgohet, brenda 10 ditëve:

- Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe të Energjetikës, për objektet ndërtimore dhe linjat e prodhimit ose shërbimit;

- Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, inventarin ekonomik e mjetet e xhiros etj.”.

c) Pika 6 shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha